



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE I MINIERAVE
DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË ENERGJISË



Tiranë, më 13.11.2023

L A J M Ë R I M

Mbi Regjistrimin dhe Kontrollin e Diplomave për Vitin Akademik 2023 – 2024
SEZONI I DIMRIT

Rektori i UPT përmes shkresës “Dërgohet Struktura Vjetore e Procesit Mësimor për Programet e Studimit të Ciklit të Parë, Programet e Integruara të Studimit të Ciklit të Dytë si dhe Programet e Ciklit të Dytë të Studimeve, për Vitin Akademik 2023-2024” (Nr.2178/2 i Protokollit UPT, datë 26.09.2023), “Struktura Vjetore e Procesit Mësimor për Programet e Studimit të “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional”, për Vitin Akademik 2023-2024” (Nr.2178/1 i Protokollit UPT, datë 26.09.2023) dhe “Struktura Vjetore e Procesit Mësimor për Programet e Studimit të “Ciklit të Parë të Studimeve dhe Programeve të Integruara të Ciklit të dytë, për Vitin Akademik 2023-2024”” (Nr.2178 i Protokollit UPT, datë 26.09.2023), ka shpallur Sezonin e Mbrojtjes së Diplomave dhe dhënies së Provimit të Formimit – Sezonin i Dimrit – Viti Akademik 2023-2024, në periudhën 19.02 ÷ 01.03.2024.

Njoftohen studentët e Programit të Studimeve “Bachelor”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” për diplomat që administrohen nga Departamenti i Burimeve të Energjisë që deri në **datën 24 NËNTOR 2023 të regjistrojnë Temën e Diplomës¹ dhe emrin e Udhëheqësit përkatës² pranë Sekretares së Departamentit të Burimeve të Energjisë (zyra e DBE, Nr. 405)³.**

Studentët e mësipërm njoftohen se në mbështetje të Rregullores së FGJM dhe DBE në **datën 15.12.2023, duke filluar nga ora 08:30** do të bëhet **KONTROLLI I PARË** i punës për përgatitjen e Temës së Diplomës. Studentët që kanë regjistruar brenda afatit Temat e Diplomës duhet të paraqesin pranë **Departamentit të Burimeve të Energjisë (zyra e DBE)/me email¹:**

1. Strukturën Paraprake të Temës së Diplomës;
2. Literaturën (titujt);
3. Materialet në versionin fillestar të tyre.

Studentët që kanë kaluar me sukses Kontrollin e Parë të Temës së Diplomës, në datën 02.02.2024, duke filluar nga ora 08:30 do të nënshtrohen Kontrollit të Dytë të saj. Ata duhet të paraqesin pranë **Departamentit të Burimeve të Energjisë (zyra e DBE) /me email¹:**

1. Strukturën Përfundimtare të Temës së Diplomës;
2. Literaturën e plotë;
3. Materialet e plota (mund të pranohen edhe në variantin bruto)⁴.

Studentët duhet të tërheqin pranë DBE Udhëzuesin mbi strukturimin e temave të Diplomave. **VETËM STUDENTËT QË KANË KALUAR ME SUKSES TË DY KONTROLLET E MËSIPËRM, KRAHAS DETYRIMEVE TË TJERA TË PARASHIKUARA NË AKTET LIGJORE DHE NËNLIGJORE NË FUQI, DHE E KANË STRUKTURUAR SIPAS KËRKESAVE TË UDHËZIMIT TEMËN E DIPLOMËS, DO TË FITOJNË TË DREJTËN PËR TU FUTUR NË MBROJTJEN E SAJ, PËRPARA KOMISIONIT PËRKATËS.**

¹ Regjistrimi mund të bëhet edhe on-line në adresat: nevtan.kodhelaj@fgjm.edu.al; preso_4@yahoo.com; nevina.koja@fgjm.edu.al.

² Rekomandohet që udhëheqësi i propozuar të jetë Pedagog Efektiv/i Ftuar pranë UPT/FGJM/DBE.

³ Ky afat vlen edhe për Studentët e prapambetur nga Diploma të tjera pranë DBE.

⁴ Pas këtij kontrolli Studentit do ti mbetet vetëm hedhja në të pastër e materialit, printimi, dorëzimi i saj si edhe përgatitja e prezantimit.